



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor

Opojë, 08 qershor 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Planifikim Hapësinor organizoi takimin e dytë të këtij Kolegjiut me 08 qershor 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në Restorant 'Liridoni' në Opojë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Udhëzues për implementimin e Planeve rregulluese (ndryshim dhe plotësim të udhëzimeve administrative për implementimin e planeve rregulluese)
- Hartimi i Rregullores për lejet mjedisore komunale (në bashkëpunim me zyrtarët ligjor dhe zyrtarët për integritime evropiane)
- Të ndryshme

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë dhe zyrtarë të Drejtorive për Urbanizëm të Komunave të Kosovës, përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, si dhe përfaqësues nga UN-HABITAT-i. Takimi u kryesua nga Kryesuesja e Kolegjiut për Planifikim Hapësinor znj. Qazime Vata.

PËRMBLEDHJE

Kryesuesja në hapjen e takimit shprehu edhe një herë brengën e saj rreth pjesëmarrjes së dobët të anëtarëve në takimet e Kolegjiut si dhe angazhimin e tyre në proceset me interes për komunat. I u është bërë një kërkesë Bordit të AKK-së që të sqarohet se cilat janë arsyet për këto mungesa të cilat mund të paraqesin pengesë për mbarëvajtjen e punës së Kolegjiut në të ardhmen.

Nga pjesëmarrësit u cek se duhet të ketë një trysni më të madhe nga vetë Kryetarët për prezencë të Drejtorëve në takimet e Kolegjiut për Planifikim Hapësinor.

- **Udhëzues për implementimin e Planeve Rregulluese (ndryshim dhe plotësim të udhëzimeve administrative për implementimin e planeve rregulluese)**

Pjesëmarrësit shprehën vërejtjet e tyre rreth Udhëzimit Administrativ (UA) për implementimin e Planeve Rregulluese në kuptim të nevojës për përmirësim apo interpretim më të saktë të tij. Komunat janë në proces të destinimit të hapësirave publike, por planet komunale duket se nuk janë gjithnjë në përputhje me këtë UA.

Zyrtarë nga UN-HABITAT-i shprehën qëndrimin e tyre se gjatë punës kanë hasur në nevojë për udhëzime rreth interpretimit të këtij UA. Në një takim të organizuar nga Shoqata e Planerëve të Kosovës është rekomanduar nevoja për interpretim/ndryshim të UA.

Diskutuesit diskutuan se çka është Plan Rregullues – a përfshin vetëm përcaktimin e hapësirave, ndërtesat dhe etazhet apo duhet të ketë detaje tjera si format e ndërtesave, ngjyrat, etj. Nje plan më detaj do duhej të specifikohet edhe në Ligjin për Planifikim Hapësinor si dhe Ligjin për Ndërtime në mënyrë që të mos ketë hapësira për keqinterpretime por të përcaktohet në mënyrë të qartë çdo

procedurë. Në fund u sqarua se Plani Zhvillimor Urban përcakton vijat e trasha dhe kriteret, ndërsa Plani Rregullues përfshin të gjitha detaje tjera ashtu sikur është e paraparë edhe me UA.

U sqarua po ashtu se Udhëzuesi i propozuar nga Kolegjiumi nuk është normativ – ai është vetëm një formë udhërrëfyese/manuali i cili nuk është obligativ por ndihmon komunat për të kuptuar më lehtë procedurat e nevojshme të cilat duhet përfillur gjatë planifikimeve. Në mungesë të një udhërrëfyese të tillë ka edhe keqkuptime të UA.

Pas shpalesjes së përvojës së komunave në këtë aspekt, u dakordua që Komuna e Gjakovës të shpërndajë përvojën e vet me të gjitha komunat tjera përmes një prezantimi në takimin e radhës të Kolegjiumit.

Një ndër brengat kryesore është madhësia e hapësirës për planifikim – a duhet specifikuar së çfarë hapësire mbulon një Plan Rregullues? Në bazë të përvojës së deritanishme, hapësira optimale për një Plan Rregullues duket të jetë rreth 10 ha – kjo hapësirë mundëson një studim të mirëfilltë, konsultim kualitativ me qytetarë si dhe planifikim dhe zbatim më të përpiktë. Ndoshta minimumi dhe maksimumi i hapësirës duhet specifikuar edhe në UA, normalisht duke ofruar fleksibilitet në përputhje me kushtet specifike në komuna si dhe ndërlidhjes së zonave të ndryshme komunale.

Si përfundim i diskutimit në këtë pikë u formua Komisioni prej 5 anëtarëve për hartimin Udhërrëfyese për Plane Rregulluese me këtë përbërje:

1. Elida Bejtullahu - Gjakovë
2. Hasije Dushi -Obiliq
3. Shpresa Osmanollaj - Prizren
4. Fadil Sherifi – Gjiilan
5. Modest – Pejës (në mungesë të Modestit në takim, ka mbetur që kryesuesja e Kolegjiumit të konfirmoj angazhimin e tij në Komision)

➤ **Hartimi i Rregullores për lejet mjedisore komunale**

Kryesuesja informoj të pranishmit se sipas informatave nga MMPH, MMPH është duke përgatitur një UA për leje mjedisore i cili pritet të aprovohet pas 2 muajsh. Një përfaqësues i MAPL-së është në grupin punues, por askush nga komunat nuk është informuar për një gjë të tillë. Andaj propozoj që të formohet një grup nga zyrtarët mjedisor komunal për të dhënë sugjerimet tona, ndërsa një përfaqësues i AKK-së të mundësisht të jetë në këtë grup punues.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) bëhet për plane/programe (përfshirë planet hapsinore dhe urbanistike), ndërsa Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM) bëhet për projekte. Kjo është bërë në Junik dhe Han të Elezit me ndihmën e UN-HABITAT-it, e që ishte rasti i parë edhe për MMPH-në për të zbatuar/interpretuar ligjin në këtë aspekt. Gjatë diskutimit kishte hamendje se kush duhet të bëjë VSM-në, kompani e cila e bënë Planin Rregullues apo ndonjë kompani tjetër për t'iu shmangur konfliktit të interesit, dhe a kanë Komunat buxhet për një gjë të tillë? Gjithsesi VSM nuk mund të aplikohet retroaktivisht për Planet që vetëm janë zhvilluar dhe janë në fuqi. Por për të sqaruar më mirë të gjitha këto, kërkohet që në një nga takimet e radhës të ftohet përfaqësuesi nga MMPH. Një çështje tjetër për të cilën duhet ftuar MMPH-në është se kjo Ministri ka anashkaluar komunat duke lëshuar leje mjedisore për ato kompani/projekte të cilat ishin refuzuar nga Kuvendet Komunale, sikur p.sh. rasti i Shtimes.

U kërkua që zyrtarët komunal për mjedis të përfshihen në Kolegjiun e Planifikimit Hapësinor sepse shumë çështje të ambientit lidhen ngushtë me Planet Zhvillimore Komunale. Për të adresuar çështjet mjedisore u formua Komisioni për mjedis i përbërë nga këta zyrtarë:

1. Fehmi Agushi - Gjilan
2. Nazif Shala - Obiliq
3. Xhelal Shabani - Mitrovicë

Meqë Drejtoritë komunale kanë dallime të mëdha, u kërkua që në këtë Kolegjiun të përfshihen edhe Drejtoritë tjera relevante siç janë Drejtoria për kadastër, mjedis, planifikim, urbanizëm, gjeodezi, etj, sepse të gjitha këto janë pjesë e planifikimit hapësinor.

➤ Të ndryshme

z. Sulejmani bëri një prezantim të shkurtër sa i përket formës së organizimit të Drejtorive relevante në komuna. Vetëm 15 komuna kanë dërguar informatat e nevojshme te Komisioni i cili është formuar në takimin e kaluar të Kolegjiut për të bërë analizën e strukturës organizative komunale në këtë fushë; por edhe disa prej këtyre përgjigjeve janë të mangëta sepse nuk specifikojnë sektorët e veçantë. U kërkua që të gjitha komunat të dërgojnë informatat e nevojshme te Komisioni, i cili do të përgatis një rekomandim për takimin e radhës të Kolegjiut.

UN-HABITAT-i ka bërë një analizë të ngjashme para disa viteve të cilën do ta shpërndan me Komisionin për ta ndihmuar punën e tyre.

Në fund z. Jozef Zuallaert nga MOBKOS bëri prezantimin e shkurtër të projektit rreth mobilitetit urban si dhe mundësinë për asistencë për të gjitha komunat të cilat kërkojnë një gjë të tillë. Të gjitha informatat e nevojshme për këtë projekt gjinden në faqen zyrtare të internetit: www.mobkos.eu

KONKLuzionet

- Kryesuesja e Kolegjiut të konfirmoj angazhimin e Modestit nga Komuna e Pejës në Komisionin për hartimin e Udhërrëfyesit për Plane Rregulluese
- Hapësira optimale për një Plan Rregullues është rreth 10 ha – ky është një rekomandim për të gjitha komunat gjatë hartimit të Planeve Rregulluese i cili ka dalë nga përvoja e deritanishme
- Në takimin e radhës të Kolegjiut Komuna e Gjakovës të prezantoj përvojën vet në hartimin e Planeve Rregulluese
- AKK-së të kërkoj përfaqësimin e vet në grupin punues të MMPH-së për hartimin e UA-së për leje mjedisore
- Në takimin e radhës të Kolegjiut të ftohen përfaqësuesit e MMPH-së për të sqaruar çështjet lidhur me Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor
- Në këtë Kolegjiun të përfshihen edhe Drejtoritë tjera si ajo e për kadastër, mjedis, planifikim, urbanizëm, gjeodezi, etj, të cilat janë pjesë e planifikimit hapësinor.

